



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 5490/7 Prot.

Pogradec, më 06 . 12 . 2021

VENDIM

Nr. 105, datë 02 . 12 . 2021

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE”
DHE “HARTA QË PËRCAKTON RRUGËT E QYTETIT ,TË CILAT PËRJASHTOHEN
NGA KJO RREGULLORE”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 1, nenit 9, pika 1, nën-pika 1.1, shkronja “a”, nenit 23, pika 14, nenit 54, shkronja “k”, nenit 64, shkronjës “c” të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; nenit 4/1 të Ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e taksave Vendore”, i ndryshuar; ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”; nenit 10, nenit 11, nenit 15 dhe nenit 17 të VKM-së nr.1096 datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”; Ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar; Vendimin e Këshillit Bashkiak “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec” për vitin 2022,

**KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:**

1. Miratimin e Rregullores për Shfrytëzimin e Hapësirave Publike dhe Hartës, që përcakton rrugët e qytetit, të cilat përjashtohen nga kjo rregullore.

RREGULLORE

“PËR SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE”

Baza Ligjore:

- Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 8, pika 1, nenit 9, pika 1, nën-pika 1.1, shkronja “a”, nenit 23, pika 14, nenit 54, shkronja “k”, nenit 64, shkronjës “c”;
- Ligji nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, nenit 4/1;
- Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e taksave Vendore”, i ndryshuar;
- Ligji nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar;
- VKM nr.1096 datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike” nenit 10, nenit 11, nenit 15 dhe nenit 17;
- Ligji nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit Bashkiak “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec” për vitin 2022.

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore përcakton rregullat, kushtet e procedurat për përdorimin, shfrytëzimin dhe menaxhimin e hapësirës publike.

Neni 2

Objekti

Objekt i kësaj rregullore janë të gjitha hapësirat publike në pronësi të Bashkisë Pogradec.

Neni 3

Përkufizime

Hapësira Publike

Hapësirë publike, është hapësira e jashtme, si trotuari, sheshi, lulishtja, parku dhe të tjerë të ngjashme në shërbim të komunitetit, ku menaxhimi mund të jetë publik dhe /ose privat. Hapësira publike përfshin rrugëkalime publike dhe mjedise që janë të hapura për publikun ose në shërbim të përdorimit publik, pavarësisht regjimit juridik të tokës dhe përtej përcaktimeve të pronës publike, sipas ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”

Neni 4

Përdorimi i hapësirave publike

Hapësira publike është pronë e përbashkët, që i përket komunitetit ku jetojmë dhe të gjithë ne jemi të barabartë kundrejt përdorimit të saj.

Është e ndaluar zënia e hapësirës publike në mënyrë të përkohshme dhe të përhershme, me çfarëdo lloj objekti, mbi ose nën të, pa lejen apo autorizimin e bashkisë apo autoritetit përgjegjës për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e tyre.

Neni 5

Leja e Shfrytëzimit

a. Lejët e shfrytëzimit të hapësirave publike jepen për një periudhë jo më të vogël se 3(tre) muaj dhe jo më të madhe se 1(një) vit dhe kanë të drejtë rinovimi.

b. Lejët e shfrytëzimit të hapësirave publike, për vendosjen e objekteve, jepen me Vendim të Kryetarit të Bashkisë .

c. Lejët e shfrytëzimit të hapësirave publike për subjektet, të cilat kërkojnë të shfrytëzojnë hapësirat publike para objektit ku ushtrojnë aktivitetin, jepen nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

d. Leja është personale/unike dhe e patrasferueshme tek çdo person/subjekt tjetër.

e. Për interes publik apo në raste kur cenohet siguria dhe shëndeti i njerëzve, lejët janë të revokueshme në çdo moment.

Neni 6

Rregullat e shfrytëzimit të hapësirës për Bare, Restorante ose Vende shërbimi.

Subjekti, në përputhje me rregulloren dhe ligjet në fuqi, duhet të shfrytëzojë hapësirën publike, sipas miratimit të bërë:

a. të sigurojë, me shpenzimet e veta dhe në kushte optimale sipërfaqen e dhënë për shfrytëzim dhe atë rreth saj si nga ana e pastërtisë dhe funksionalitetit;

b. të kujdeset që objektet e vendosura në sipërfaqen e dhënë për shfrytëzim të jenë në gjendje të mirë si nga ana funksionale dhe ajo estetike;

c. të përdorë hapësirën publike në mënyrë të tillë që të mos kufizojë, shkaktojë dëme ose të shkelë të drejtat e palëve të treta;

d. të shmangë krijimin e situatave të rrezikshme ose të pengimit të qarkullimit të mjeteve dhe kalimit të këmbësorëve;

e. të ketë në zotërim ambjentin para hapësirës që kërkon të zhvillojë;

f. të bëjë pagesën e tarifës brenda afateve të përcaktuara;

g. në momentin që subjekti nuk ka më të drejtë për shfrytëzimin e hapësirë publike si rrjedhojë e mos zbatimit të detyrimeve ose nëpërmjet kërkesës së tij, ta kthejë këtë hapësirë në gjëndje funksionale ashtu si ishte para marrjes në dorëzim;

h. Hapësira publike / trotuari , për të garantuar një zonë lëvizëse për këmbësorët, duhet të jetë 2.5 (dy pikë pesë) metra.

j. Hapësirat publike / trotuaret, të cilat nuk garantojnë zonën lëvizëse të këmbësoreve prej 2.5

(dy pikë pesë) metra ,nuk do të mund të pajisen me lejë të përkohëshme shfrytëzimi, përveç rrugëve të përcaktuara në hartën bashkëlidhur kësaj rregullore.

Neni 7

Shfrytëzimi i hapësirave publike për tregtimin e artikujve të ndryshëm

Shfrytëzimi i hapësirës publike, për tregtimin e artikujve të ndryshëm, biznese të tjera të ngjashme apo shitës ambulant, lejohet si më poshtë:

a. Përdorimi i hapësirës nga shitësit ambulant, lejohet vetëm në rastet kur ato janë të grupuar në tregje, në hapësira të përcaktuara nga pushteti lokal.

b. Aprovimi i vendndodhjes do shoqërohet me modelin e kioskes respektive si dhe detyrimet që përfituesi do të ketë, për përdorimin e kësaj hapësirës publike.

c. Këto biznese (dyqan, tregtimi i artikujve të ndryshëm, biznese të ngjashme. janë të detyruara të kryejnë veprimtarinë e tyre, brenda hapësirës, ambjentit që zotërojnë, (kanë në përdorim., duke mos cënuar në asnjë mënyrë, hapësirën publike.

d. Ekspozimi i produkteve të tregtuara, duhet të bëhet vetëm brenda fasadës së ambjentit, ku biznesi ushtron aktivitetin dhe jo jashtë saj.

e. Gjithashtu për çdo element të shtuar të fasadave respektive, që është pjesë e hapësirës publike, sikurse tenda, cadra, reklame etj, nevojitet lejë nga autoritetet përkatëse.

Neni 8

Dokumentet e kërkuara, për fillimin e procedurave, për dhënien e lejës së shfrytëtimit të përkohshëm së hapësirës publike

1. Subjektet e interesuara, duhet të paraqesin në Zyrën me një ndalesë dokumentet e mëposhtme;
 - a. Fotokopje të mjetit identifikues.
 - b. Kërkesë për pajisjen me leje shfrytëzimi .
 - c. Çertifikatën e regjistrimit të subjektit.
 - d. Vërtetim që subjekti nuk ka detyrime vendore.
 - e. Fotokopje të librezës së ujit (duhet të mos ketë detyrime deri në ditën e aplikimit.
 - f. Fotokopje të librezës së energjisë elektrike (duhet të mos ketë detyrime deri në ditën e aplikimit.
 - g. Dy foto në këndet e ndyshme të hapësirës ku të kuptohet si fasada e ambjentit si dhe hapësira para saj (trotuari).
2. Në rastet kur aplikimi për pajisje me leje shfrytëzimi të hapësirës publike ka mangësi në dokumentacioni , leja refuzohet.
3. Kërkesat paraqiten pranë Zyrës me një ndalesë, pranë Bashkisë Pogradec.
4. Subjekti pajiset me leje shfrytëzimi, pasi të kryejë detyrimet e pagesave për hapësirën të cilën kërkon të marrë në shfrytëzim.

Neni 9

Afatet

- a. Bashkia Pogradec del me vendim brenda 10 ditëve për dhënien apo jo të shfrytëzimit të hapësirave publike.
- b. Afati 10 ditor përjashtohet atëherë kur kërkuesi nuk plotëson detyrimet financiare dhe në rastet kur zonat e kërkuara nuk janë zona me studime plani.

Neni 10

Mbajtja e dokumentave

- a. Subjekti i pajisur me lejën e shfrytëzimit duhet të mbajë dokumentet në ambjentet që ushtron aktivitetin.
- b. Mos mbajtja e dokumenteve në mënyrë të përsëritur konsiderohet si shkelje dhe gjobitet me gjobë. Përsëritja në mënyrë të vazhdueshme e shkeljes bëhet shkak për heqjen e lejes së shfrytëzimit.

Neni 11

Përjashtime

Përjashtohen nga kjo rregullore të gjitha subjektet në rastet e përdorimit të hapësirës publike që përjashtohen me VKB "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec" për vitin 2022.

Neni 12

Miratimi i hapësirës publike

1.Hapësirat publike,të cilat janë të lira për t'u dhënë në përdorim për arsye biznesi,përcaktohen në këtë rregullore.

2.Çdo hapësirë tjetër e papërfshirë në Hartën bashkëlidhur kësaj rregullore,nuk do të mund të pajiset me lejë të përkohëshme shfrytëzimi.

Neni 13

Rregullat e shfrytëzimit të hapësirës publike gjatë sezonit turistik Maj – Shtator

1. Kërkesa për shfrytëzimin e hapësirës publike gjatë sezonit turistik kryhet nga data 15 Mars - 15 Prill.
2. Subjektet duhet të pajisen me NIPT- Ambulant.
3. Subjektet zhvillojne aktivitetin e tyre vetëm në zonën e miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak.
4. Në rast se subjekti shfrytëzon hapësirë publike më tepër se leja e dhënë, subjekti nuk ka më të drejtë të shfrytëzojë hapësirën publike.

Neni 14

Dokumentat

- 1.Subjektet e interesuara duhet të paraqesin në zyrën me nje ndalesë dokumentat më poshtë:

- a. Fotokopje të mjetit identifikues.
- b. Kërkesë për pajisjen me lejë shfrytëzimi.
- c. Çertifikatën e regjistrimit të subjektit.
- d. Vërtetim që subjekti nuk ka detyrime vendore.
- e. Fotokopje të librezës së ujit (duhet të mos ketë detyrime deri në ditën e aplikimit).
- f. Fotokopje të librezës së energjisë elektrike (duhet të mos ketë detyrime deri në ditën e aplikimit).
- g. Dy foto në këndet e ndyshme të hapësirës, ku të kuptohet si fasada e ambientit si edhe hapësira para saj (trotuari).
- h. Leja jepet për një periudhë jo më pak se 90 ditë.

Në rastet kur aplikimi për pajisje me lejë shfrytëzimi të hapësirës publike ka mangësi në dokumentacion, leja refuzohet.

Kërkesat paraqiten pranë zyrës me një ndalesë, pranë Bashkisë Pogradec.

Subjekti pajiset me lejë shfrytëzimi, pasi të kryejë detyrimet e pagesave për hapësirën të cilën kërkon të marrë në shfrytëzim.

Neni 15

Rregullat për dhënien e lejës për zhvillimin e aktivitetit të mjeteve lundruese

- a. Kërkesa për shfrytëzimin e hapësirës, për vendosjen e varkave, bëhet në periudhën 15 Mars - 15 Prill.
- b. Subjeket të jenë të pajisura me NIPT.
- c. Subjektet zhvillojnë aktivitetin vetëm në zonat e miratuara në VKB (harta).

- d. Varkat të cilat pajisen me lejë nga Bashkia Pogradec do të vendosin logon e Bashkisë në pjesë të dukshme të varkës.
- e. Leja për zhvillimin e aktivitetit jepet për një periudhë jo me pak se 90 ditë.

Neni 16

Rregullat për shfrytëzimin e hapësirës për vendosjen e pedanave në lulishte

Subjekti, në përputhje me rregulloren dhe ligjet në fuqi, duhet të shfrytëzojë hapësirën publike, sipas miratimit të bërë:

- a. të sigurojë, me shpenzimet e veta dhe në kushte optimale sipërfaqen e dhënë për shfrytëzim dhe atë rreth saj si nga ana e pastërtisë dhe funksionalitetit;
- b. të kujdeset që objektet e vendosura në sipërfaqen e dhënë për shfrytëzim të jenë në gjëndje të mirë si nga ana funksionale dhe ajo estetike;
- c. të përdorë hapësirën publike në mënyrë të tillë që të mos kufizojë, shkaktojë dëme ose të shkelë të drejtat e palëve të treta;
- e. të ketë në zotërim ambjentin para hapësirës që kërkon të zhvillojë;
- f. të bëjë pagesën e tarifës brenda afateve të përcaktuara;
- g. në momentin që subjekti nuk ka më të drejtë për shfrytëzimin e hapësirës publike si rrjedhojë e mos zbatimit të detyrimeve ose nëpërmjet kërkesës së tij, ta kthejë këtë hapësirë në gjëndje funksionale ashtu si ishte para marrjes në dorëzim;

Neni 17

Dokumentat e kërkuara ,proçedura dhe afatet për dhënien e lejës së shfrytëzimit të hapësirës për vendosjen e pedanave në lulishte

-1.Kërkesa e lejës së shfrytëzimit të hapësirës, për pedanat në lulishte, bëhet në zyrën me një ndalesë pranë Bashkisë Pogradec në periudhën 1 Mars – 31 Mars.

Subjektet e interesuara duhet të paraqesin dokumentat si më poshtë:

- a. Çertifikatën e regjistrimit të subjektit.
- b. Fotokopje të mjetit identifikues.
- c. Vërtetim që subjekti nuk ka detyrime vendore.
- d. Kërkesë për pajisjen me lejë.
- e .Planvendosjen + Projekt + Foto çadre + Foto karrige.

-2. Komisioni miraton kërkesat e paraqitura në periudhën 1 Prill – 20 Prill.

Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë si më poshtë:

- Nënkryetar.
- Drejtor i Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes së Infrastrukturës dhe Punëve Publike.
- Drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit.
- Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore.
- Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.

-3. Pasi subjekti ka kryer ndërtimin e pedanës, bën kërkesë për Akt- Piketimin dhe Çertifikatën e përdorimit, në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore ,brënda 10 ditëve.

Organi Inspektues, i cili përbëhet nga përfaqësues të drejtorive si më poshtë, bën verifikimin në terren, mban procesverbal dhe lëshon Çertifikatë Përdorimi për subjektin:

- Policia Bashkiake.
- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.
- Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit.
- Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.

Leja e shfrytëzimit të hapësirës, për pedanat në lulishte , jepet jo më pak se 60 ditë.

Në rastet kur Organi Inspektues, konstaton shkelje nga subjekti, të kushteve të përcaktuara në lejën e shfrytëzimit, zbatohet ligji për IMT.

Subjekti pajiset me lejë shfrytëzimi, pasi të kryejë detyrimet e pagesave për hapësirën të cilën kërkon të marrë në shfrytëzim.

2. Bashkëlidhur këtij vendimi është "Harta që përcakton rrugët e qytetit, të cilat përjashtohen nga kjo rregullore".
3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit ,Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Policia Bashkiake për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes publike.

KRYETAR
Sotirag MANGËR

